RAPORTI TEKNIK I PROJEKTIT TË PROPOZUAR.

"NDËRTIMI I HEC "KOTORRI"

PËR SUBJEKTIN:

"ACHELO" sh.p.k

Ekspert Mjedisi:

Studio "AM-RES"

Tiranë, 2019

Permbledhje:

- QËLLIMI I PROJEKTIT TË PROPOZUAR 3
- PLANIMETRI E VENDNDODHJES SË PROJEKTIT, KU PASQYROHEN NË HARTË TOPOGRAFIKE KUFIJTË E SIPËRFAQES, TË SHOQËRUAR ME KOORDINATAT, SIPAS SISTEMIT KOORDINATIV KRGJSH, FOTOGRAFI DHE TË DHËNA PËR PËRDORIMIN EKZISTUES TË SIPËRFAQES QË DO TË PËRDORET PËRKOHËSISHT APO PËRHERË NGA PROJEKTI, GJATË FAZËS SË NDËRTIMIT APO FUNKSIONIMIT TË VEPRIMTARISË: 3
- INFORMACION PËR QENDRAT E BANUARA, NË ZONËN KU PROPOZOHET TË ZBATOHET PROJEKTI, SHOQËRUAR ME FOTOGRAFI DHE TË DHËNA PËR DISTANCËN E TYRE NGA VENDNDODHJA E PROJEKTIT TË PROPOZUAR, SI DHE PËRCAKTIMIN E NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE QË ADMINISTRON TERRITORIN KU PROPOZOHET PROJEKTI: 7
- SKICAT DHE PLANIMETRITË E OBJEKTEVE DHE STRUKTURAVE TË PROJEKTIN, SI DHE MËNYRAT DHE METODAT QË DO TË PËRDOREN PËR NDËRTIMIN E OBJEKTEVE DHE STRUKTURAVE TË PROJEKTIT; 8
- PËRSHKRIMI I PROCESEVE NDËRTIMORE DHE TEKNOLOGJIKE, PËRFSHIRË KAPACITETET PRODHUESE PËRPUNUESE, SASITË E LËNDËVE TË PARA DHE PRODUKTET PËRFUNDIMTARE TË PROJEKTIT; 12
- INFORMACION PËR INFRASTRUKTURËN E NEVOJSHME PËR LIDHJEN ME RRJETIN ELEKTRIK, FURNIZIMIN ME UJË, SHKARKIMET E UJËRAVE TË NDOTURA DHE MBETJEVE, SI DHE INFORMACIONIN PËR RRUGËT EKZISTUESE TË AKSESIT APO NEVOJËN PËR HAPJE TË RRUGËVE TË REJA: 14
- PROGRAMI PËR NDËRTIMIN, KOHËZGJATJEN E NDËRTIMIT, KOHËZGJATJEN E PLANIFIKUAR PËR FUNKSIONIMIN E PROJEKTIT, KOHËN E MUNDSHME TË PËRFUNDIMIT TË FUNKSIONIMIT TË PROJEKTIT DHE FAZA E PLANIFIKUAR E REHABILITIMIT TË SIPËRFAQES, PAS MBARIMIT TË FUNKSIONIMIT TË PROJEKTIT 17
- LËNDËT E PARA QË DO TË PËRDOREN PËR NDËRTIMIN DHE MËNYRA E SIGURIMIT TË TYRE (MATERIALE NDËRTIMI, UJË DHE ENERGJI 22
- INFORMACIONIN PËR LIDHJET E MUNDSHME TË PROJEKTIT ME PROJEKTE TË TJERA EKZISTUESE PËRRETH/PRANË ZONËS SË PROJEKTIT: 22
- INFORMACION PËR ALTERNATIVAT E MARRA NË KONSIDERATË, PËR SA I TAKON PËRZGJEDHJES SË VENDNDODHJES SË PROJEKTIT DHE TEKNOLOGJISË QË DO TË PËRDORET: 23
- TË DHËNAT PËR PËRDORIMIN E LËNDËVE TË PARA GJATË FUNKSIONIMIT, PËRFSHIRË SASITË E UJIT TË NEVOJSHËM, TË ENERGJISË, LËNDËVE DJEGËSE DHE MËNYRËN E SIGURIMIT TË TYRE; 23
- AKTIVITETE TË TJERA QË MUND TË NEVOJITEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT, SI NDËRTIMI I KAMPEVE APO REZIDENCAVE ETJ: 23
- INFORMACION PËR LEJET, AUTORIZIMET DHE LICENCAT E NEVOJSHME PËR PROJEKTIN, NË PËRPUTHJE ME PËRCAKTIMET E BËRA NË LEGJISLACIONIN NË FUQI, SI DHE INSTITUCIONET KOMPETENTE PËR LEJIMIN / AUTORIZIMIN/ LICENCIMIN E PROJEKTIT: 24
- KOPJE TË LEJEVE, AUTORIZIMEVE DHE LICENCAVE QË DISPONON ZHVILLUESI PËR PROJEKTIN E PROPOZUAR, NË PËRPUTHJE ME PËRCAKTIMET E BËRA NË LEGJISLACIONIN NË FUQI, SI DHE INSTITUCIONET KOMPETENTE PËR LEJIMIN / AUTORIZIMIN/LICENCIMIN E PROJEKTIT. 24

1. Raporti teknik i projektit të propozuar:

➢ *Qëllimi i projektit të propozuar*

Qëllimi themelor i projektit të propozuar është prodhimi i pastër i energjisë elektrike duke realizuar një vlerësim te përgjithshëm të integruar dhe në kohë të ndikimeve mjedisore të projektit me synim parandalimin dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis. Proçesi i vlerësimit do të jetë i hapur dhe i administruar me paanshmëri, nëpërmjet pjesëmarrjes së plotë të organeve qëndrore e vendore, organizatave jofitimprurëse për mjedisin, publikut, propozuesit të projektit dhe personave fizike juridik, specialistë të kësaj fushe. Realizimi i ndërtimit të hidroçentralit, përveç qëllimit kryesor të prodhimit të energjisë elektrike, do të ndikojë pozitivisht dhe në përmirësimin e kushteve social-ekonomike të komunitetit të zonës. Zhvillimi i këtij aktiviteti bazohet në studimet e hershme dhe të reja të shfrytëzimit të rrjetit hidrologjik të pjesëve të përroit të Seltës. Shoqëria investitore ka angazhuar grup specialistësh përkatësisht të gjeologjisë, hidrogjeologjisë, topografisë, eko-ambjentalistë dhe pejsazherë në të gjithë pellgun ujëmbajtës të luginës, veçanërisht në pjesët ku do të ndërtohet Hec.Kotorri.Ky aktivitet si pasoje e zhvillimit të projektit, qëllimit dhe ndërhyrjes në mjedis klasifikohet si: ndërtimi i hidrocentraleve të vegjël lumorë. Ai përveç qëllimit kryesor të prodhimit të energjisë elektrike do të sjellë impakte pozitive nëpërmjet:

- Ndërtimit të objekteve të prodhimit të energjisë elektrike me impakt negativ minimal në mjedis.
- Rritjen e punësimit dhe të specialistëve të fushës gjatë fazës së ndërtimit dhe shfrytëzimit të veprës.

➢ ***Planimetri e vendndodhjes së projektit, ku pasqyrohen në hartë topografike kufijtë e sipërfaqes, të shoqëruar me koordinatat, sipas sistemit koordinativ KRGJSH, fotografi dhe të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes që do të përdoret përkohësisht apo përherë nga projekti, gjatë fazës së ndërtimit apo funksionimit të veprimtarisë:***

❖ Vendodhja e Objektit:

Objekti Hec. Kotorri ndodhet ne:

Njësia administrative:	Zavalinë dhe Pishaj.
Fshati	Seltë dhe Kotorr
Bashkia :	Elbasan dhe Gramsh.
Qarku :	Elbasan.

Planimetria e vendndodhjes së nënobjekteve të Hec. KOTORRI.

SKEMA E VENDOSJES SE NENOBJEKTEVE NE HARTËN TOPOGRAFIKE TË HEC.KOTORRI



HIDROCENTRALI "KOTORRI"

1. VENDNDODHJA

BASHKIA: ELBASAN DHE GRAMSH, **FSHATI:** KOTORR
QARKU: ELBASAN

2. POZICIONI GJEOGRAFIK.

BËN PJESË NË BASENIN UJËMBLEDHËS TË LUMIT "DEVOLL" NË PËRROIN E SETËS.
DEGË E LUMIT DEVOLL.
NË KUOTA ABSOLUTE TË PËRCAKTUARA NË HARTËN TOPOGRAFIKE NË SHKALLE 1: 25000.

2.1 HIDROCENTRALI KOTORRI.

TIPI I HIDROCENTRALIT ME DERIVACION

1- GODINA E CENTRALIT NË KUOTËN;

+178m mnd.

2- VEPRAT E MARRJES

a- e tipit të thjeshtë në kuotat absolute,

+245 m. (Në perroin e Setës).

3. PARAMETRAT ENERGJITIK.
HIDROCENTRALI KOTORRI

PRURJA MESATARE: 1.51m³/sek,
PRURJA LLOGARITËSE: 2.6 m³/sek,
PRURJA EKOLOGJIKE: 0.1 m³/sek,
PRURJA PER BUJQESI: 60 Liter/sek,

FUQIA E INSTALUAR E HEC-IT; N = 1340 kW.

KOORDINATA E NËNOBJEKTEVE (GAUSS-KRUGER)

HIDROCENTRALI	X (EASTING)	Y (NORTHING)	Z
VEPRA E MARRJES.	44 33 435	45 33 377	+245
BASENI PRESIONIT	44 33 550	45 33 009	+243
GODINA HEC-IT	44 29 981	45 32 577	+178

KOORDINATA E NËNOBJEKTEVE (KRGJSH)

HIDROCENTRALI	X (EASTING)	Y (NORTHING)	Z
VEPRA E MARRJES.	51 75 27	45 32 965	+245
BASENI PRESIONIT	51 76 46	45 32 599	+243
GODINA HEC-IT	51 40 82	45 32 125	+178

LEGJENDA

- GODINA E HEC-it.
- TUBACIONI I TURBINAVE
- BASENI I PRESIONIT
- SIFONI
- VEPER MARRJE
- TUB.SHKARKIMIT
- LINJA ELEKTRIKE

OBJEKTI: HIDROCENTRALI KOTORRI	BASHKIA ELBASAN, GRAMSH	PROJEKTUES: "AM-RES" SH.P.K	EMERTIMI I FLETES:	SHKALLA: SH 1:25000	DATA 07/2019
FAZA: PROJEKT ZBATIM	QARKU ELBASAN	POROSITËS: "ACHELO" SH.P.K	SKEMA E VENDOSJES SE NENOBJEKTEVE NE HARTEN TOPOGRAFIKE TË HEC.KOTORRI		Nr.FLETES H/C-01

❖ **Kordinatat e nënobjekteve te hec.Kotorri.**

KORDINATA E NENOBJEKTEVE TE HEC KOTORRI				
Nr.	NËNOBJEKTI	KORDINATAT NE KRGJSH		KUOTA
		X	Y	
1	VEPRA E MARRJES	51 75 27	45 32 965	(+245)
2	BASENI PRESIONIT	51 76 46	45 32 599	(+243)
3	GODINA E HECIT	51 40 82	45 32 125	(+178)

❖ **Fotografi dhe të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes që do të përdoret nga projekti, gjatë fazës së ndërtimit dhe funksionimit të veprimtarisë.**

Siperfaqja e Zones qe do te perdoret per Zhvillimin e projektit aktualisht sot eshte e lire nga objektet e tjera. Te vepra e marrjes dhe nenobjektet e tjera te Hec-it nuk kemi zhvillime te objekteve te tjera dhe ndertimi i tyre realizon marrjen dhe perdorimin e ujit e ujit duke mos ndikuar ne ndryshime te theksuara te shtartit te perroit dhe territoit ku ndertohen nenobjektet e tjera .

❖ **Foto te gjendjes aktuale te zonës ku do te ndertohen nenobjektet e Hec.Bukaniku**

- ***Informacion për qendrat e banuara, në zonën ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar me fotografi dhe të dhëna për distancën e tyre nga vendndodhja e projektit të propozuar, si dhe përcaktimin e njësisë së qeverisjes vendore që administron territorin ku propozohet projekti:***

Zona ku do te zhvillohet prjekti i ndertimit te Hec.Kotorri ndodhet jashte teritorit te zonave me status te veçant mbrojtje.Lidhja e objektit me rruge ekzistuese dhe ushtrimi i aktivitetit te shfrytezimit nuk prek zonat turistike dhe zonat e mbrojtura, sepse ne objektin e projektuar dhe per rreth nuk ka zona te mbrojtura me status te vecante. Eshte per t'u theksuar se nuk ka asnje veper arti te ndertuar nga njeriu.Nuk ka monomente te cultures apo ndonje object arkeologjik ne kete territor.



Projekti zhvillohet ne:

Njesia administrative Zavalinë dhe Pishaj.

Bashkia Elbasan dhe Gramsh.

Qarku Elbasan.

Distanca me e afert e nenobjekteve te Hecit nga banesa me e afert e fshatit 500m.

- ***Skicat dhe planimetritë e objekteve dhe strukturave të projektin, si dhe mënyrat dhe metodat që do të përdoren për ndërtimin e objekteve dhe strukturave të projektit;***

Hec.Kotorri.

Vepra e marrjes Nr,1 , ndertohet ne lartesite +245.0 m mnd ku mund te shfrytezoje maksimalisht prurjet e ujit te përroit të Seltës (degen kryesore te tije), ne masen me te madhe te rrjedhave mbi kete kuote, sidomos te burimeve te ujit.

Dekantuesi, me gjatesi rreth 45 ml ndjek nje trase me nje renie me pjerresi 3‰, deri ne te hyrja e Sifonit .

Sifoni, me gjatesi rreth 380 ml ndjek nje trase me nje renie me pjerresi të ndryshme deri ne te hyrja e Basenit të presionit eshte tub çeliku i pozicioinuar në nëntokë.

Baseni i presionit, i vendosur pas Sifonit ne kuoten +343m, me strukture b/arme me gjatesi rreth 14 ml vendoset si zgjatim i ifonit dhe lidhet me tubacionin e presionit ne pjesen fundore te tjie.

Tubacioni i presionit me gjatesi rreth 3886 ml ndjek nje trase me nje renie me pjerresi te madhe ne nje krahe e lugines ne ane te lumit te Holtes poshte bashkimit te tije me përroin e Seltes deri ne afersi te derdhjes se tij ne liqenin e Banjes poshte fshatit Kotorri ku eshte vendosur Godina e Hecit, i gjithe tubacioni do te pozicionohet ne nentoke ne krahun e djathte te Lumit.

Godina e centralit do te ndertohet ne kuoten +178.0m mnd, ne afersi te Lumit te Holtes para derdhjes se lumit ne liqen, e pozicionuar ne nje sheshe te pershtatshem karakterizuar nga nje formacion i qendrueshem nga ana gjeologjike. Bazamentet dhe Godina e Hecit jane strukture b/arme.

Kanali i shkarkimit do te kete nje gjatesi rreth 60ml dhe do ta leshoje ujin ne Lumin e Holtes ne piken fundore te tije para bashkimit me Liqenin e Banjes.Per ndertimin e nenobjekteve do te shfrytezohen rruget egzistues te cilat jane te shumte ne zone dhe shkojne shume afer tyre.

Skema e shfrytezimit te potenciolit Hidroenergjitik te Perroit.

Vepra e marrjes se ujit është e tipit te thjeshte Tyrolez me zgare te vendosur ne pjesen e siperme te kaperderdhesit ,ne nje shkallzim te Kaperderdhesit eshte lene dhe pjesa e ujit te lire per ekologjine. vepra e marrjes është me strukture beton/arme e pozicionuar ne formacion baze ne aksin e përroit, e llogaritur teknikisht per te marre ujin per prodhim energjie dhe per te percjedhe ujin e plotave dhe ate ekologjik.Permasimi i saje eshte bere ne funksion te perballimit te plotes sipas standarteve te projektimit (kushtit teknik te projektimit).

Tipi i vepres se marrjes.



PRERJA TERTHORE E VEPRES SE MARRJES (5-5)



Dekantuesi

Pas veprave te marrjes eshte vendosur dekantuesit i cili bene te mundur dekantimin e grimcave deri ne permasat e lejuara per turbinen.Dekantuesi eshte i pozicionuar ne pjesen me te madhe ne toke dhe pak dalin muret anesore ne siperfaqe, është te ndertuar me strukture beton/arme.Struktura e tije eshte e thjeshte dhe eshte te ndare ne dhome per dekantimin sa me te mire te grimcave.



Sifoni.

Nga dalja nga dekantuesi, nepermjet sifonit uji perfundon ne Hyrje e Basenit te presionit ne kuoten+243.0 (niveli normal i ujit ne basenin e presinit) .

Ky sifon percjell per te Baseni i Presionit ujin e vm. (pra Qllog = 2.6m3/sek).

Ndertimi i ketij sifoni te permbysur perdoret per te kaluar ujin ne nje depresion natyral nga nje krrah ne tjetrin. Ne rastin tone sifoni do te bej te mundur dergimin e prurjes qe vjen nga dalje e Dekantuesit per te hyrja e Basenit te presionit.

Per te percaktuar kuoten e hyrjes dhe daljes te sifonit duhet te llogarisim sakte humbjet hidraulike, gjatesore dhe humbjet e vendi.

Veprat kryesore te sifonit jane vepra e hyrjes, vepra e daljes dhe tubacioni i dergimit.

Prurja e sifonit eshte 2.6m³/s.

Gjatesia e tubacionit 350 m.

Baseni i Presionit.

Ne pergjithesi pozicioni i basenit te presionit vendoset ne fundin e vepres se derivacionit dhe realizon hyrjen ne kushte te caktuara te prurjes ne tubacionin e turbines. Ne rastin tone ai vjen mbas Sifonit.Ne rastet me te pergjithshme baseni presionit perbehet nga dy elemente kryesore:Paradhoma, e cila eshte pjesa rakorduese midis kanalit te derivacionit,ose dekantuesit ne rastin tone, dhe pjesa marrjes ose lidhja me tubacionin e turbinave. Baseni i presionit është

pozicionuar mbas Sifonit qe vijne nga dekantuesi i Hecit,duke lejuar plotesimin e kritereve të nevojshme të kalimit të ujit nga dekantuesi në tubacionin e turbines që i takon sistemit nën presion.Baseni i presionit është vendosur në kuotën (+243m),formacioni gjeologjik ku vendoset baseni është pershtatshëm.





Godina e Hecit.

Godina e Hecit eshte e vendosur (ne kuoten +178m), ne funde te tubacionit te presionit ne afersi te lumit te Holtës poshte fshatit Kotorri dhe ne te do te vendosen dy agregate frencis. Ne afersi te godines do te vendosen dhe transformatoret qe jane pjese e nenstacionit te hecit.Uji qe del nga turbinat derdhet ne lume nga kanali i shkarkimit fundor te Godines,Struktura e godines eshte me Strukture beton/arme per bazamentet e turbines dhe gjeneratorit dhe me Gure vendi per Muret.Turbinat e tipit frencis jane te standarteve europiane dhe me nje numer rrotullimesh prej 750 rrot/min qe ka nje zhurme te vogel.

Planimetria e Godines se hecit.



- ***Përshkrimi i proceseve ndërtimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese përpunuese, sasitë e lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit;***

❖ **Pershkrimi i procesit ndertimor per Hec. Kotorri.**

Ndertimi i nenobjekteve te Hec Kotorri do te filloje me hapjen e traseve te tubacioneve duke shfrtytezuar rruget ndihmese te zones te cilat jane egzistuese;Hapja e traseve do te behet e tille qe te shfrytezohet per te shkuar te vepren e marrjes e cila do te ndertohen ne shtratin e përroit dhe do te jete, me strukture beton-arme, dhe ne kthim do te ndertohet tubacioni i presionit, qe lidhë basenin e presionit me Godinen e centralit.

❖ **Lendet e para qe do te perdoren per ndertim.**

Për ndërtimin e objektit do të përdoren materialet si: Beton,hekur,tuba ,çelik tulla,konstruksione metalik,tulla për ndërtimin e ambjenteve të shërbimit,dhe material të tjera të rifinaturës,si alumin xham,llaç.etj.te cilat do te sigurohen pjeserisht me materialin e gurit qe del nga germimet dhe nje pjese e inerteve do te merren ne pikat me te aferta me zonen ku do te ndertohet Hec-i. Karburanti do te furnizohet nga subjekte te liçencuara per import, ruajtje dhe tregtim te karburanteve ne republiken e Shqiperise. Ndersa per mbrojtjen nga pluhuri, per nevoja vetiake, mbrojtjen nga zjarri dhe sherbime te tjera do te perdoret uje. Uji qe do te perdoret per pregatitjen e betonit dhe perdorimet e tjera eshte i bollshem dhe gjendet ne afersi te nenobjekteve per pije do te sigurohet nga burimet ku sigurohet dhe nga banoret e fshatrave ku do te zhvillohet projekti.Ndertime te objekteve te sherbimit do te behet me materialet e lehta sanduici qe do te merren te gatëshme nga subjekte të specializuara. Sasia 3 kontoniere.

❖ **Percaktimi kapacitetit prodhues.**

Ne godinene Hec.Kotorri, do te instalohen dy aggregate tip francis sipas standarteve Evropiane me nje numer rrotullimesh te vogla prej 750 rrot/min,per efekt te zhurmave te vogla qe paraqesin gjate regjimit te punes se tyre.

Parametrat e Hec.Kotorri			
1	*Prurja llogaritese*	*m3/sek*	*2.6*
2	*Renja neto*	*m*	*61*
3	*Fuqia e Instaluar*	*kW*	*1340*
4	*Energjia (Viti i mestsr ,50%)*	*kwh/vit*	*4,310,000.0*

❖ **Produkti perfundimtar i prodhuar.**

Produkti perfundimtar eshte prodhimi i energjise elektrike duke shfrytezuar potencialin hidroenergjtik te ujit.

➢ ***Informacion për infrastrukturën e nevojshme për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujërave të ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacionin për rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja:***

❖ **Infrastruktura e nevojshme për lidhjen me rrjetin elektrik**

Zona furnizohet me energji elektrike pa nderprerje, por ndëprerjet sporadike te energjise e kane prekur dhe ate rralle here e kryesisht gjate dimrit si pasoje e difekteve nga ngricat, e theksuar kjo sidomos ne fshatin Seltë dhe Kotorri qe jane me afer Hec-it. Megjithate, jane bere perpjekje per te permiresuar infrastrukturen e energjise elektrike ne kete drejtim. Ndertimi I Hec-it rrit kapacitetin prodhues te energjise elektrike dhe i vjen me afer kerkesave te banoreve prane tij.

Infrastruktura e projektuar dhe ajo egzistuese për ndërtimin e Hec Kotorri dhe linja e energjise elektrike për lidhjen me nenstacionin jane projektuar ne perputhje me kushtet klimaitike dhe mjedisore te zones.

- Te gjitha ndertesat apo strukturat e vendosura ne lartesi duhet te pajisen me rrufepritesa statike ne menyre qe te presin rrufete e rena ne kohe shtrengatash.
- Mbrojtja mekanike ne varesi nga instalimet dhe aplikimet e paisjeve elektrike, mbrojtja sipas klasave behet sipas standartit IEC 60529.

Qellimi themelor i projektit eshte prodhimi i paster i energjise elektrike duke realizuar vlerësim te përgjithshëm të integruar dhe në kohë të ndikimeve mjedisore të projektit me synim parandalimin dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis.

Ne kete menyre,do te shfrytezohen rezervat hidroenergjitike te përroit të Seltës, por gjithnje duke ber te mundur qe nje minimum ujerash te percaktuar ne kete studim gjate gjithe periudhes se funksionimit te lihet te rrjedhe ne shtratin natyror te përroit direkt nga vepra e marrjes per arsye ekologjike. Gjate punimeve, do te kete ndikime negative, te cilat do te jene te perkoheshme sepse do te jene te pranishme vetem gjate fazes se ndertimit te Hec-it. Gjate shfrytezimit te tyre, keto ndikime negative nuk do te ekzistojne me, nderkohe qe efektet pozitive nga projekti do te ndihen gjate gjithe kohes ne vijim.

❖ **Furnizimin me ujë.**

Ne pjesen me te madhe te nenobjekteve uji eshte shume afer pasi punohet ne afersi te fshatrave dhe eshte i mundur furnizimi me uje, ne ato nenobjekte ku uji eshte larg, furnizimi do te behet me depozite qe do te furnizohet me autobot qe ka ne perdorim subjekti.

SKICA E FURNIZIMIT ME UJE



❖ **Shkarkimet ne mjedis dhe prodhimi i mbetjeve.**

Zhvillimi i aktivitetit do te sjell emetime te pluhurave ne mjedis gjate ndertimit te objektit, burime te tjera ndotese per ajrin nuk do te kete. Pajisjet qe do te perdoren per shfrytezimin dhe transportin e materialeve dhe te dheut do te jene bashkohore dhe ne gjendje te mire teknike ne menyre qe te shmangen emetimet nga djegia e lendeve djegese qe ato perdorin.

Ne vende te caktuara ne projekt (shesh-depozitimi) parashikohet depozitimi i materialit te nga germimet dhe perpunimi i tij me toke vegjetale per te mundesuar mbjelljen e bimeve dhe pemeve karakteristike te zones gjate fazes se rehabilitimit. Dherat e depozituara ne damba do te perpunohen me dhera te pasura me humuse, do te transportohen dhe shperndahen ne sheshin e shkalleve te skarpatave dhe shesh-depozitimit me trashesi mbi 20cm dhe do te pyllezohen me bime qe rriten ne zone per gjelberimin e saj.

Zona nuk ka fasilitete te trajtimit te ujerave re zeza apo heqjes se mbeturinave te ngurta. Ujerat e zeza te fshatrave qe ndodhen kryesisht ne taracat lumore te degëzimeve te perrenjeve dhe i derdhin ato ne keto perrenj, gje e cila bie ndesh me parametrat e cilesise se ujerave te embel dhe per trajtimin e ujerave me qellim ruajtjen e tokes dhe ujerave siperfaqesore dhe nentokesore nga ndotja, gjate ndertimit te hec-ve do te ndertohen gropa septike per trajtimin e ujrave ne godinen e Hec-it.



Në kohën e ndërtimit të rrjetit të jashtëm të kanalizimit, ujërat e zeza të dala nga objekte të veçuara apo zona të tëra të qendrave të banuara (në rastin tone të godinës së centralit) mund të mblidhen në gropa septike (të zeza), nga të cilat, në kohë të caktuara largohen me mjete të ndryshme transporti (autobote etj) të autoritetit përkatës Ujësjellës Kanalizime sh.a.

Në këto gropa lëndët organike që përmbajnë ujërat e zeza kanë aftësi të dekantojnë lehtë meqë shpejtësia e rrjedhjes së këtyre ujrave prodhon gaze me erë të rëndë dhe zvogëlon vëllimin e tij. Kështu një gropë septike përfaqëson një farë dekantuesi të mbyllur, tek i cili bëhet dekantimi i ujrave të zeza dhe kalbëzimi i llumit të dekantuar. Gropat septike mund të kenë një, dy ose tri ndarje nëpër të cilat ujërat e zeza kalojnë nga e para në të dytën e kështu me radhë. Në seksionin e parë, dekantimi është më i madh, prandaj edhe përmasat e tij merren më të mëdha se të seksioneve të tjera. Llumi, sidomos në të ndarën e parë, ngjeshet mirë dhe zvogëlon vëllimin 3-4 herë. Lëndët në gjendje pezull notojnë në sipërfaqe dhe aty duke u tharë e duke u ngjeshur formojnë një farë cipe. Në mënyrë që ujërat e zeza të hyjnë normalisht në gropë e të dalin prej saj pa u penguar nga kjo cipë e krijuar, tubat e hyrjes dhe të daljes, si dhe vrimat ndërmjet ndarjeve të gropës pajisen me tridegësh (pjesë T). Vrimat e lëna në muret ndarëse kanë përmasa (15x15)cm.Gropat septike ndërtohen me tulla, gurë, me beton monolit ose me element të parapërgatitur prej betoni.

Për të mënjanuar daljen e gazeve e të erës së keqe, gropat septike, nga sipër soletës mbulohen me argjilë të përzier me zhavorr ose me skorje me një trashësi që luhatet midis 0.5 dhe 0.8m. Në disa raste, kur pozicioni i gropës septike nuk prish ambientin higjieno-sanitar të truallit, gropat

septike ndërtohen të filtrueshme, megjithatë në rastin e godinës së centralit ky rast nuk duhet zgjedhur në mënyrë kategorike, sepse godina do të pozicionohet pranë shtratit të përroit çka do të sillte ndotje të tij.

Këto gropa që mund të kenë formë të rrumbullakët ose drejtkëndëshe ndërtohen siç u përshkruan më lart, me gurë, me tulla, me beton ose butobeton. Në fund të gropës shtrohen disa shtresa me zhavorr me madhësi të kokrrizave 1 deri në 10 cm. Pjesa e poshtme e mureve të gropës mund të ndërtohet me vrima ose muratura mund të ndërtohet pa llaç në mënyrë që të dalin ujërat e filtruara.

- **Informacionin për rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja.**

Ne zonen e ndertimit ka shume rruge egzistuese te shfrytezimit te inerteve dhe pyjore dhe qe ne shume nenobjekte shkojne deri te sheshi i ndertimit te tyre

- Gjate fazes se ndertimit do te shfrytezohen rruget egzistuese duke i rehabilituar ato me ndikime minimale ne aspektin mjedisor.
- Gjate fazes se shfrytezimit qarkullimi i automjeteve do te jete i kufizuar dhe nuk do te perbeje rrezik sinjifikativ per aksidente.Korridore te hyrje-daljeve ne veper dhe rruget komunikuese te objekteve behen ne vende të pershtashme e pa prishur breza pyjor te bregperroit. Rruget te reja qe do te hapen nga shoqeria investitore nuk ka, por do te rehabilitohet ajo ekzistuese e cila sherbente per fshatin si rruge sherbimi per te bregu i lumit. Kjo rruge me pas do te mirembahet ne nevoje te vepres dhe te komunitetit te zones.

Persa i perket energjise elektrike per kantierin e ndertimit lidhja do te behet ngarrjeti kryesor i zones icili eshte ne afersi dhe ne rastin e ndertimit te tubacionit te presionit etj do te perdoren gjeneratore.

- ***Programi për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar për funksionimin e projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe faza e planifikuar e rehabilitimit të sipërfaqes, pas mbarimit të funksionimit të projektit***

- **kohëzgjatjen e ndërtimit.**

Per ndertimin e Hidrocentraleve do te duhen 24 muaj i cili do te behet sipas nje programi me grafik organizimi te punimeve kohe qe fillon me marrjen e lejes se ndertimit nga KRRT per ndertimin e hidrocentrait.

❖ **Kohëzgjatjen e planifikuar për funksionimin e projektit.**

Per ndertimin e Hidrocentralit do te duhen 24 muaj (pas zbardhjes se lejes se nderimit), I cili do te behet sipas nje programi me grafik organizimi te punimeve kohe qe fillon me marrjen e lejes se ndertimit nga MEI per ndertimin e hidrocentralit.Kohëzgjatjen e planifikuar për funksionimin e projektit eshte 49 vjet sipas kontrates me MIE.duke qene se ndertimi i kapaciteteve nen 2MW nuk jane objekt i koncesionit.

❖ **Koha e mundshme e përfundimit**

Pas 24 muajsh do te perfundoj instalimi i turbines dhe fillimi i prodhimit te energjise elektrike afati i fillimit te punimeve merret nga zbardhja e lejes se ndertimit te dhene nga MEI.

❖ **Faza e planifikuar e rehabilitimit të sipërfaqes.**

Reabilitimi i sheshit te ndertimit per ato pjese qe perfundojne ndertimin si trasete e tubacioneve dhe te nenojekteve te tjera behet menjehere pas perfundimit te ndertimit dhe reabilitimi i plote i zones se ndertimit parashkohet 3 muaj pas perfundimit te plote te objektit .

Reabilitimi i zones konsiston ne minimizimin e efekteve negative shkaktuar nga ndertimi I objektutit.

❖ **Plani dhe masat per reabilitimin e Mjedisit te Zones.**

Per rehabilitimin e kesaj siperfaqeje te perdorur per ndertimin e nenobjekteve te Hecit, i cili do te filloje ne vitin e pare te shfrytezimit te objektit, Subjekti ne zbatim te legjislacionit Shqiptar do te paguaj garancine bankare te rehabilitimit dhe ne varesi te kushteve ose do ta rehabilitoje vet zonen e shfrytezuar per ndertim ose do ja delegoje ndonje subjekti te specializuar.

❖ **Punimet e rehabilitimit konsistojne si me poshte.**

- Krijimin e siperfaqeve per mbjellje
- Sistemimin e materialit te mbuleses te depozituar paraprakisht ne kufijte e sheshit te ndertimit.
- Mbjelljen e siperfaqeve te reja me drure si dushk, pishe dhe dellinje bimesi e cila eshte aktuale ne kete objekt dhe barishte te ndryshme.
- Mirembajtjen e siperfaqeve te mbjella.

❖ **Masat zbutese te ndikimeve negative gjate procesit te shfrytezimit.**

Masat zbutese te ndikimeve negative konsistojne ne uljen e ndotjeve gjate punimeve te ndertmit te hec-it te ajrit nga pluhuri, gazet mbrojtja nga zhurma, si dhe uljen e efekteve negative

hapsinore dhe ne territor, ne faunen dhe floren. Por pikesynimi kryesor i studimit mbetet rehabilitimi i tokes dhe evitimi ne maksimum i erozionit.

❖ **Masat konkrete qe do te merren gjate punimeve.**

- Mbjellje me filiza pishe, dellinje, dushk,akacie dhe bimeve te vendit e periferise me te lartet e shpatit te territorit gjate ndertimit dhe pas ndertimit.
- Kjo mase do te sherbeje edhe per uljen e nivelit te pluhurave dhe zhurmave ne vazhdim te projektit, si dhe te rrise mundesimin per vetegjenerim te drureve ne pjesen e larte me shpatin tjeter te kodres.
- Pemiresimin e bimesise ne te gjitha periferine e nenobjekteve me bimesi te zones kryesisht dushk, per te izoluar pjesen e fragmentizuar nga shfrytezimi prej atyre te paprekura nga projekti duke lene mundesine per perhapje te metejshme te ketyre specieve vendase ne territoret fqinje.
- Te dy keto masa mund te sherbejne si barriera per pluhurin qe mund te nxirret nga aktiviteti eolik gjate shfrytezimit
- Uljen e pluhurit per stinen e veres me lagje te sheshit duke evituar keshtu me sa te jete e mundur pluhurat dhe sidomos, lagia e materialit te rruges. Kjo do te mbroje ambjentin nga pluhuri gjate zhvillimit te aktivitetit.

❖ **Rehabilitimi i territorit.**

Masat rehabilituese do te konsistojne ne:

- Uljen e erzionit
- Restaurimin e habitateve
- Pasurimin e biodiversitetit me speciet natyrore.
- Rritjen e vlerave vizuale dhe rikrijuese te territorit qe do te shfrytezohet.

Se pari ndertimin e taracave te rregullta në shpatet me pjerresi te madhe, per te lehtesuar zbatimin e planit te rehabilitimit. Keto tarraca do te lejojne mbulimin e siperfaqes me gjelberim dhe evitimin e pamjeve te pakendeshme te shpateve vertikale te tarracave qe mund te mbeten zbuluar ne rastet e lartesise se pergjithshme te tarraces rreth 5m.

Rradha e mbjelljeve do te jete nga lart-poshte, duke lejuar mundesine per veteperhapjen e specieve mbi bazat e aktivitetit eolitik dhe forces se rendeses. Gjeresia e shkalles se taraces do te jete 1.5m. Kjo lloj mbjellje lejon veteperhapjen e species, si dhe nuk demton ne rritjen e bimeve pasi nuk pengon dritezimin.

❖ **Rehabilitimi i tokes**

Per rehabilitimin e tokes, do te shfrytezohen mbetjet e imeta nga materiali i nxjerre dhe do te plotesohet me 10 cm dhera humusore te pasur me pleh.

Nese do te nevojitet stabilizimi i ketij dheu nje pjese e faqes se pjerret do te behet me trungje te ngulura me thellesi 30 cm, mulcirimi do te jete I thate dhe me kashte, me gjethe të bimeve te zones dhe me dege. Mulcirimi do te sherbeje si per uljen e humbjeve te farave nga largimi prej aktivitetit eolik, ashtu dhe per uljen e aktivitetit erodik persa kohe vegjitacioni eshte I pazhvilluar mire. Mbjelljet do te kene renditjen me largesi fidanesh cdo 10m, gje qe do ti jape nje kurorë dendesie mjaft të mire territorit pas ndertimit, dhe lejon dritezimin per vete - rritjen dhe zhvillimin e bimeve natyrore.

❖ **Mbjellja e taracave**

- Mbjellje dhe sistemimi I skarpatave te derivacionit dhe nenobjekteve ne pergjethesi.
- Mbyllje e rrugeve ndihmese dhe sistemimi i tyre,
- Filiza 2 vjecare ne periferi
- Mbjellje e filizave 2 vjecare te pemeve dhe lejimi I perteritjes se shkurreve

Nga vete rehabilitimi i habitateve me perparsi do te marre rritja e abundances se shpendeve dhe zvarranikeve dhe njekohesisht do te shtohen si habitatet ashtu dhe rezervat natyrore edhe per gjitaret e larte si lepuri etj. Prej ketej do te rritet edhe mundesia e pranise se mishngrenesve te larte si qelbesit dhe buklit (nuses se lales).

❖ **Kanalet dhe kunetat.**

Kunetat dhe kanalet ne rruget ndihmese dhe ato egzistuese do te bejne qe rrjedhja e ujrave siperfaqsore te behet me force rendese, duke perftuar ne kete menyre grumbullimin e tyre dhe me pas depertimin gradual ne toke.

Kombinimi i punimeve te ndertimit me ato te zbutjes se impakteve mjedisore si dhe punimet rehabilituese, do te kete si pasoje edhe rritjen e numrit te te punesuarve.

❖ **Punime biologjike**

- Mbushja me dhera humusore me trashesi 30 cm te shesheve te shkalleve dhe pergatitja e tokes per mbjellje me bimesi.

- Mbjellja e drureve, pishe dhe dushk, dellinje etj, duke qene se ne kete zone me klime mesdhetare me dimer te ftohtë dhe vere te nxehte e me lageshti kjo bimesi zhvillohet me lehtesi.
- Mbjellja e bimesise.
- Sherbimet profilaktike ne siperfaqet e rehabilituara.

❖ **Punime biologjike biodiversiteti.**

Ndryshueshmeria biologjike e zones kushtezohet nga veprimi klimave mesdhetare. Ne kete zone eshte prania e bimesise mesdhetare si, dushku dellinja dhe rralle ndonje pishe por te gjitha keto jane te rralla pasi shkembijte bazike dalin direkt ne siperfaqe dhe mungon toka vegjetale mbi to ose eshte shume e vogel e cila ne disa raste shkon deri 0.2m.

Bimesia e larte ne formen e pyjeve masive mungon dhe dominohet nga llojet e siperpermendura dhe dushknajat qe jane deshmitare te pranise se tyre masive ne te kaluaren.

Gjitaret e medhenj qe takohen ne kete zone jane dhelpra qe eshte shtuar ndjeshem, ujku lepuri I eger, nusja e lales, ketri.

Ne kete kat shkurrore ka si mbulese ne masen me te madhe te tij bimesia barishtore qe eshte ne varesi te drejtperdrejte te mikroklimave dhe eshte rezultat I veprimtarise antropogjene.

Nisur nga koncepti i teresise ekologjike keto habitate kane vlera dhe duhet te rehabilitohen.Per kete ne zonen e kryerjes se punimeve do te mbillet bimesia e zones dhe bimesi e kultivuar si, ullinj, akacie, prrale dhe dushke, ne te gjitha sheshet e sigurimit qe do te dalin per cdo horizont shfrytezimi.

Distance ndermjet drureve te larte do te jete 6 metra dhe ndermjet rrjeshtave 4 metra. Numri I rreshtave do te jete nefunksion te gjeresise se shesheve te sigurimit.Pervec filizave do te mbillen edhe bimet barishtore ne sheshet e shkalleve per te krijuar siperfaqe te gjelber. Mbjellja e tyre do te permisoje ne menyre te dukshme peisazhin e zones dhe do te ndikojë ne rritjen e popullimin e numrit te gjitareve, shpendeve dhe zvarranikeve, sepse do te krijohen kushte te nevojshme per zhvillimin e tyre, te folenizimit dhe do te eleminohet fenomeni i erozionit.Per ndertimin e nenobjekteve do te shfrytezohen rruget egzistues te cilat jane te shumte ne zone dhe shkojne shume afer ,dhe ne gjithe nenobjekte jane deri te vendi i ndertimit te tyre.Per ndertimin e nenobjekteve do te perdoren sipas rastit dhe struktures materiale nga vendi si gure te cilet jane te shumte ne kete pellg.

- ***Lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin dhe mënyra e sigurimit të tyre (materiale ndërtimi, ujë dhe energji***

Per ndertimin e nenobjekteve do te perdoret struktura beton/arme dhe gure, te cilat do te sigurohen pjeserisht me materialin e gurit qe del nga germimet dhe nje pjese e inerteve do te merren ne pikat me te aferta me zonen ku do te ndertohet Hec-i. Karburanti do te furnizohet nga subjekte te liçencuara per import, ruajtje dhe tregtim te karburanteve ne republiken e Shqiperise. Ndersa per mbrojtjen nga pluhuri, per nevoja vetiake, punonjesit, mbrojtjen nga zjarri dhe sherbime te tjera do te perdoret uje. Uji qe do te perdoret per pregatitjen e betonit dhe perdorimet e tjera eshte i bollshem dhe gjendet ne afersi te nenobjekteve per pije do te sigurohet nga burimet ku sigurohet dhe nga banoret e fshatrave ku do te zhvillohet projekti.Ky aktivitet eshte ndertimi i Hec. Kotorri i cili konsiston ne prodhimin e energjise elektrike duke perdor ujin e përroit të Seltës. Uji perdoret j o vetem per prodhimin e energjise nepermjet hidroturbines por d h e rast pas rasti per lagien e territorit ne menyre qe te mos kete krijim te pluhurave gjate veprimtarise se germimeve dhe transportit, sidomos ne kohe te thate dhe me ere, kjo sasi uji sigurohet permes depozitave te ujit qe shoqeria siguron per kete qellim. Lendet djegese qe perdorin mjetet e transportit sigurohet ne pika te furnizimit me karburant. Ndertimet e objekteve te sherbimit do te behet me material te lehta sanduici qe do te merren te gateshme nga subjekte te specializuara. Sasia 3 konteniere.

SKICA E SHESHIT TE KANTJERIT



- ***Informacionin për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth/pranë zonës së projektit:***

Aktiviteti i ndertimit te hidrocentralit Kotorri behet ne nje territor ku nuk ka projekte te tjera qe jane duke u zhvilluar aktualisht, persa i perket lidhjes me sistemin elektrik Lidhja e HEC.Kotorri. do te realizohet nepermjet nje linje 35kv me nenstacionin Cerrunjë.

- Gjatesia e linjes 3600 m
- Tensioni i linjes 35 kV

- ***Informacion për alternativat e marra në konsideratë, për sa i takon përzgjedhjes së vendndodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret:***

Shoqeria ***"ACHELO"***sh.p.k, ka marre Miratimin paraprak per ndertimin e Hec.Bukaniku, në përputhje me ligjin nr.43/2105 "Për sektorin e Energjisë Elektrike", Referuar Pikes 10 te Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr.822, date 7.10.2015 "Per miratimin e rregullave dhe procedurave te ndertimit te kapaciteteve te reja prodhuese te energjise elektrike, qe nuk jane objekt koncensioni" i ndryshuarsi ,duke perzgjedhur kete zone sepse ndodhet ne afersi te rruges ekzistuese ka kushte te mira shfrytezimi te potencialit Energjitik te përroit të Seltës,larg qendrave te banuara si dhe kapacitet te konsiderueshem ne prodhimin e energjise elektrike.

Theksojme per organet vendimmarrese, se mundesia e alternativave te marra ne konsideratë per perzgjedhjen e vendodhjes se projektit nga subjektet ndertuese ne teresi jane ne nivele te kufizuara per keto arsye:

- Zona e ndertimit per shfrytezim te potencialit ujor, percaktohet nga MIE me propozim te Subjektit dhe shqyrtimit e miratimit te AKBN pas plotesimit te nje sere kushtesh teknike dhe financiare nga Subjekti i interesuar per kete aktivitet.
- Investitori ka perzgjedhur kete zone per investim pasi eshte zone e lire nga pikpamja e shfrytezimit te potencialit ujor dhe eshte e vetmja mundesi per shfrytezim ne kete zone (duke shfrytezuar përroin e Seltës) .

- ***Të dhënat për përdorimin e lëndëve të para gjatë funksionimit, përfshirë sasitë e ujit të nevojshëm, të energjisë, lëndëve djegëse dhe mënyrën e sigurimit të tyre;***

Uji perdoret j o vetem per prodhimin e energjise nepermjet turbinave por dh e rast pas rasti per lagien e territorit ne menyre qe te mos kete krijim te pluhurave gjate diteve te nxehta dhe kur eshte e nevojshme, sidomos ne kohe te thate dhe me ere, kjo sasi uji sigurohet perms depozitave te ujit qe shoqeria siguron per kete qellim. Lendet djegese qe perdorin mjetet e transportit sigurohet ne pika te furnizimit me karburant.

- ***Aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si ndërtimi i kampeve apo rezidencave etj:***

Ne fazen e ndertimit te Hidrocentralit nuk do te do te kete nevoje per ndertim te kampit pasi punetoret do te akomodohen ne fshatin me te afert, ku dhe do te jete dhe numeri me i madh i punetorve, per mbajtjen e materialve dhe organizimin e punimeve do te instalohen tre kontinier te cilet do te sigurohen te gatshme nga subjekte qe dispunojne te tilla.

- ***Informacion për lejet, autorizimet dhe licencat e nevojshme për projektin, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin / autorizimin/ licencimin e projektit:***

Pasi eshte marre Miratimi Paraprak nga MIE per vazhdimin e procedurave te metejshme per marrjen e lejes se ndertimit per Hec.Kotorri, pjese e procedures per marrjen e lejes se ndertimit eshte dhe pajisja me Leje mjedisore (Vendim per VNM Paraprake).

- ***Kopje të lejeve, autorizimeve dhe licencave që disponon zhvilluesi për projektin e propozuar, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin / autorizimin/licencimin e projektit.***

Per zhvillimin e projektit Zhvilluesi deri ne kete faze disponon Miratimin Paraprak nga MIE per ndertimin e Hec. Kotorri qe i hap rruge fazes se plotesimit te dokumentacionit per marrjen e kontrates perfiundimtare dhe lejes se ndertimit.

Referencat e burimeve të informacionit të përdorur.

1. *Gjendja mjedisore e disa lumenjve të Ultësirës Adriatike Shqiptare (A. Miho et. Al 2005);*
2. *Tokat e Shqipërisë (F. Gjoka, Tiranë2003);*
3. *Strategjia Kombëtare dhe Plani Veprimit për Biodiversitetin,Tiranë1999;*
4. *Raporti i gjendjes së mjedisit 2012;2016l2014,2015*
5. *Studime për biodiversitetin,* Tiranë 2007;
6. *Gjeografia Fizike e Shqipërisë (Vëllimi I dhe Vëllimi II) (Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Qendra e Studimeve Gjeografike, Tiranë 1991);*
7. *Shpendët dhe gjitarët e Shqipërisë (T. Bino, F. Bego, H. Zoto* 2006);
8. *FZHSH. Të dhëna demografike dhe ekonomike për komunat, 2010;*
9. *CENSUS 2011*
10. *Bego, F. 1997. Current threat status of the mammals of Albania. Libri i kuq i bimëve, shoqërimeve bimore dhe kafshëve të Shqipërisë;*
11. *Haxhiu, I. 1998. The reptilia of Albania: species composition, distributin, habitats;*
12. *Bino, T., Zoto H &, Bego F. 2006. Birds and mammals of Albania. Shpendët dhe Gjitarët e Shqipërisë) isbn 99943-815-5-5;*
13. *Lamani, F., & Puzanov, V. 1962. Inventarizimi i shpendëve të Shqipërisë.Buletini I Shkencave Natyrore 3, 4: 87-101;*
14. *Misja, K. Libri i kuq i faunës shqiptare. 2006. Red data book of Albania"s fauna;*
15. *Aliaj, SH. 1982. General Features of Neotectonic Structure of Albania. Athens: Earthquake Risk Reduction in Balkan Region, UNESCO;*
16. *Aliaj, SH. 1998. Neotectonic structure of Albania. Albanian: Journal of Natural and Technical Sciences. 4, 79-98;*
17. *Aliaj, SH. September 10-13, 2000. Active Fault Zones in Albania. Lisbon, Portugal XVII Gen. Ass. of ESC, in "Book of Abstracts and Papers". 74;*
18. *ANFI. 2001. Albanian National Forest Inventory, Terms of Reference. Tirana;*
19. *Protected Area Map of Albania, Ministry of Environment, Forestry and water Administration, Albania;*
20. *PSR Albania. 1983. Geological Map of PSR of Albania, 1983, Based on geological and geophysical ëork carried out in Albania until 1981: 1:200,000, Tirana;*
21. *Preparing a georeferenced soil database for Albania at scale 2:250,000 using*
22. *Website të ndryshme në internet.*

Ekspert Mjedisi

Studio : "AM –RES' sh.p.k

REPUBLIKA E SHQIPËRISË Sh.p.k AM - RES Nuis : L 62015011 T TIRANE - ALBANIA

MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISE DHE SIPERMARRJES

QKB
Qendra Kombëtare e Biznesit
National Business Center

Numri serial: LN-3491-07-2017
NUIS/NIPT: L62015011T

LICENCË

Subjekti: AM-RES

Adresa: Tirane, TIRANE, Tirane, TIRANE, Bulevardi Zogu i I, Pallati Kosovarit, Kat.6, apartamenti.6

Kodi: III.2.A (1+2)

Kod tjetër:

Data e lëshimit: 03/07/2017

Afati i vlefshmërisë: Pa afat

Kategoria

Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis

Nënkategoria

Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis

Veprimtari specifike

1. Ndikim në mjedis
2. Auditim mjedisor

Specialiteti

Emërtimi përshkrues i veprimtarisë

Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis [Auditim mjedisor dhe Vlerësimi i ndikimit në mjedis].

Kufizime specifike

Licenca ushtrohet sipas kufizimeve në legjislacionin në fuqi

Detyrime specifike

Licenca ushtrohet sipas detyrimeve në legjislacionin në fuqi

Vendi i kryerjes së veprimtarisë

Në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Nënshkrimi i sportelit: _____

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT TREGTISË DHE SIPERMARRJES
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AM-RES
Nuis: L 62015011 T
TIRANË - ALBANIA

Ky dokument mbahet pronë e Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe duhet të kthehet në rast se ka ndryshim të ndonjë detaji ose ndërprritet detyrimi ligjor për të qenë person i tatuesheëm.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT

Nr. 5063 Prot. Tiranë, më 22.06.2017

Nr. identifikues 350

ÇERTIFIKATË

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 122, datë 17.02.2011 Për një ndryshim në Vendimin Nr. 1124, datë 30.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe kritereve për pajisjen me certifikatën e specialistit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor":

Z. EKREM XHAFERI

Çertifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË SH.P.K. AM - RES Nuis : L 62015011 T TIRANË - ALBANIA

MINISTRI

Lefter KOKA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E MJEDISIT TIRANË

MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES

QKB
Qendra Kombëtare e Biznesit
National Business Center

NUMRI SERIAL:
SN-429053-08-16

ÇERTIFIKATË REGJISTRIMI

Personit të tatueshëm:

AM-RES – Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar

Statusi:

Aktiv

Me adresë kryesore:

Tirane,Tirane, Bulevardi Zogu i I, Pallati Kosovarit, Kat.6, apartamenti.6

I jepet ky numër identifikimi (NUIS):

L62015011T

Afati i veprimtarisë:

Nga: 12/08/2016 deri

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Sh.p.k.
AM-RES
Nuis : L 62015011 T
TIRANË - ALBANIA

Per Hec. Kotorri

DATA E REGJISTRIMIT
15/08/2016

DATA E LËSHIMIT
15-08-2016

SPORTELI I SHËRBIMIT:

QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

(Emri, Mbiemri) i nëpunësit të sportelit

Kjo çertifikatë është rreptësisht e ndaluar të plastifikohet

Ky dokument mbetet pronë e Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe duhet të kthehet në rast se ka ndryshim të ndonjë detaji ose ndërpritet detyrimi ligjor për të qenë person i tatueshëm.

MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES

OKB
Qendra Kombëtare e Biznesit
National Business Center

Numri serial: LN-2447-12-2016
NUIS/NIPT: L62015011T

LICENCË

Subjekti: AM-RES

Adresa: Tirane, TIRANE, Tirane, TIRANE, Bulevardi Zogu i I, Pallati Kosovarit, Kat.6, apartamenti.6

Kodi: IV.4.C

Kod tjetër:

Data e lëshimit: 20/12/2016

Afati i vlefshmërisë: Pa afat

Kategoria

Sherbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me burimet minerare, hidrokarbure dhe energjitike

Nënkategoria

Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me burimet energjetike

Veprimtari specifike

Specialiteti

Emërtimi përshkrues i veprimtarisë

Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me burimet energjetike (Kategoritë 3/a, 5/a,b,f, 6/a, 7,a, 9/c,e dhe 10/e.)

Kufizime specifike

Licenca ushtrohet sipas kufizimeve në legjislacionin në fuqi

Detyrime specifike

Licenca ushtrohet sipas detyrimeve në legjislacionin në fuqi

Vendi i kryerjes së veprimtarisë

Në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë

Nënshkrimi i sportelit: [signature]

Për Hec. Kotorri

REPUBLIKA E SHQIPËRISË Sh.p.k. AM - RES Nuis : L 62015011 T TIRANË - ALBANIA

Ky dokument mbetet pronë e Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe duhet të kthehet në rast se ka ndryshim të ndonjë detaji ose ndërpritet detyrimi ligjor për të qenë person i tatueshëm.